**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**
Opština Priština –Municipality of Prishtina

PRISHTINA

01-2247

# Njoftim publik

Në Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, është dorëzuar kërkesa me reference 05 nr.350/02-0246761/18 dt.10.10.2018 të pronarëve **Gani Kçiku, Sabit Kastrati, Mujo Rexhepi dhe Isni Rexha** nga Prishtina, me investitor **"Koniprojekt" sh.p.k.**, me adresë në rr."Rexhep Krasniqi", lagja "Kalabria", në Prishtinë, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim të ndërtesave shumëbanesore&afariste, në parcelat kadastrale nr.1873-3, 1873-4, 1873-7, 1873-8 dhe 1873-10 ZK Prishtinë, në kuadër të bllokut "C2" të Planit Rregullues "Kalabria" dhe Planit Zhvillimor Urban - PZHU.

Komentet lidhur me këtë propozim (propozimi i kërkuesit) duhet të dorëzohen nga data 24.10.2018 deri më 08.11.2018, në e-mail adresën: **urbanizmiprishtine@rks-gov.net**

| Kushtet e propozuara të ndërtimit | |
|---|---|
| a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: | Ndërtesa shumëbanesore&afariste |
| b. Vija rregulluese | - |
| c. Vija ndërtimore (nga kufiri I parcelës) | - |
| d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike | ~37.2 m' (pika me e larte e kulmit) |
| e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale. | 0.5 x lartësia e ndërtesës, dhe min.7.0m' pa ndriçim primar |
| f. Lartësia e lejuar e propozuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale | 0.5 x lartësia e ndërtesës, dhe min.7.0m' pa ndriçim primar |
| g. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale | 20-40% e sipërfaqes së parcelës (brenda vijës rregulluese) |
| h. Përqindja e sipërfaqes se gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale | ~20 % e sipërfaqes së parcelës se lire |
| i. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale | - |
| j. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale | ~60% |
| k. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve | - |
| l. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese | po |
| m. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja | - |
| n. A ka qasje te pakufizuar ne rruge publike dhe infrastrukturë publike? Po Jo x Nuk aplikohet □ | |
| o. shfrytëzimi i propozuar a do te gjenerojë ndotje te mjedisit apo zhurmë me te madhe se sa zona për rreth? Po □ Jo X Nuk aplikohet □ Sqaro: | |
| p. A është ndonjë nga punët ndërtimore ne Zona te Mbrojtura, Zona te veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po □ Jo X Nuk aplikohet □ Sqaro: | |

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet tuaja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrtarit: